

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit Islam Thaçi, me Procesmbajtësin Ali Kryeziu, në lëndën penale kundër të pandehurit P. Q, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 275, par.1 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II. nr. 1637/2016, të datës 09.09.2016, të cilën e përfaqëson Prokurori i Shtetit Esat Ademi, pas mbajtes së seancës së shqyrtimit fillestar gjyqësor dhe publik, më 19.07.2017 ,shpalli publikisht dhe të njejtin ditë hartoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri P. Q, nga babai S dhe nëna M, e lindur S, i lindur më datën ..në V, R. e S, me vendbanim në Gj, , i martuar, baba i një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së varfer ekonomike , shqiptar , Shtetas I Republikës së Kosovës, i dënuar më parë, si dhe udhëhiqen edhe procedura tjera penale ndaj tij .

Ë shtë f a j t o r

Sepse më datë 23.08.2016, rreth orës 17:45 min , në Gj, në mënyrë të paautorizuar ka poseduar narkotik, në atë mënyrë që me rastin e bastisjes në dhomën e tij të fjetjes, nën dyshek, i është gjetur substancë narkotike me peshë ..gram, e vendosur në një letër, me ç'rast sipas testit Fushor ka rezultuar se substanca narkotike është e llojit..., e cila është ...sekuestruar.

Me çka ka kryer veprën penale, posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 275, par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitës së lartëcekur ligjore si dhe neneve: 4,7, 41, 45, 46, 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK-së, e lidhur me nenin 365 të KPPK-ës, të pandehurit, i shqipton:

DËNIM ME BURG DHE ME GJOBË

Ashtu që të pandehurit P. Qi shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve dhe dënim me gjobë në shumë prej 200 euro, të cilat dënime do të ekzekutohen pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri ...nuk dëshiron, ose nuk mund ta paguajë gjobën, atëherë gjykata të njëjtit në kuptim të nenit 46, paragr 3, të KPRK-së, do t' ia zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke ia llogaritur një ditë burgim me 20 euro gjobë.

Detyrohet i pandehuri ...që të paguajë shpenzimet e procedurës penale, përkatësisht paushallin gjyqësor në shumë prej 50 €, në afat prej 15 ditësh, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës se prerë, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Konform nenit 275 paragrafi 3, të KPPRK-së, të pandehurit të lartëcekur i konfiskohet substanca narkotike e llojit heroinë në peshë prej 0.6 gram.

A r s y e t i m

Prokuroria Temelore në Gjilan, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzë kundër të pandehurit P. Q, për shkak të veprës penale, posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 paragrafi 1 i KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën për shqyrtim fillestar në të cilën kanë prezentuar prokurori i shtetit Esat Ademi si dhe i pandehuri ...

Pas leximit të aktakuzës, i pandehuri P.Q, e ka kuptuar aktin akuzues, përkatësisht veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata e ka njoftuar të pandehurin me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 parag. 1 i KPPK-së, pas këtij njoftimi, i pandehuri e ka pranuar fajësinë, për veprën penale, posedimi i paautorizuar i narkotikëve,substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 paragrafi 1 i KPRK-së, në pajtim me përshkrimin faktik si në dispozitiv të aktakuzës.

Prokurori i shtetit Esat Ademi në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar: gjatë seancës së sotme të shqyrtimit fillestar duke u bazuar në faktin, se i pandehuri P. Q, e ka pranuar veprën penale e cila i vihet në barrë sipas kësaj aktakuze, edhe pas njoftimit të kësaj gjykate, për pasojat dhe benifitet e pranimi të fajësisë, ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat tjera materiale, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, fakte këto në bazë të cilave vërtetohet në tërësi se i njëjti, ka kryer veprën penale, ashtu si që është e përshkruar në dispozitivin e kësaj aktakuze, për çka mbetem në tërësi pranë kësaj aktakuze dhe kërkoj nga gjykata që të njëjtin t'a shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

Përkitazi me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit i propozoj gjykatës që t'i merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

I pandehuri P. Q, në fjalën e vet përfundimtare, deklaron: si në fillim të seancës, po edhe në fjalën përfundimtare e pranoj fajësinë për veprën penale të cilën ma ngarkon aktakuza, pendohem për të njëjtën, jam aktualisht në vuajtje të dënimit, i martuar, baba i një fëmiu, pa kushte materiale për ekzistencë, i premtoj gjykatës se kam gabuar më parë, po edhe për këtë vepër penale, kështu që i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisw në asnjë mënyrë vepra të kësaj natyre apo të ngjashme, sepse jam vetëdijësuar se këto vepra janë të dëmshme dhe se kam ardhur në përfundim që këto vepra penale më shkaktojnë dëme mua dhe familjes, andaj kërkoj nga gjykata që brenda mundësive ligjore të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

Gjyqtari ka vlerësuar se i pandehuri, e ka pranuar fajësinë dhe se pranimi është bërë pasi që i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajit nga i pandehuri është bërë vullnetarisht, i mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza si dhe në materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit.

Aktakuza poashtu nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, prandaj në këtë çështje penale gjendja faktike nuk ka qenë kontestuese, andaj gjykata ka gjetur se i pandehuri Përparim Qerimoviq, në vendin dhe kohën e përshkruar si në dispozitiv të aktgjyqimit, ka kryer veprën penale,posedimi i paautorizuar i narkotikëve,substancave psikotrope ose

analoge nga neni 275 paragrafi 1 i KPRK-së, për çka është edhe penalisht përgjegjës, andaj të pandehurin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit për të pandehurin, gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikim që dënimi të jetë më i butë apo më i rëndë, ashtu siq e parasheh edhe dispozita e nenit 73 dhe 75 të KPRK-së.

Gjykata në rastin konkret ka gjetur rrethana lehtësuese të cilat mundësojnë shqiptimin e dënimit si në dispozitiv të aktgjykimit, përmes të cilit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 dhe 50 të KPRK-së. Si rrethanë lehtësuese për të pandehurin, gjykata pati parasysh faktin se i njejtë e ka pranuar fajsinë për veprën penale të kryer, se i pandehuri është i pa punësuar, i martuar, prind i një familje, i gjendjes së varfër ekonomike.

Ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin, gjykata pati parasysh, shkallën e përgjegjësisë penale, sjelljen e mëparshme të pandehurit, gjegjësisht faktin se i njejtë është recidivist, i dënuar me një (1) vit e gjashtë muaj burg, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374/1 të KPRK-së me aktgjykimin e plotfuqishëm të kësaj gjykate, P.KR.nr.220/16, me aktgjykimin, P.nr. 421

Me dënimin e shqiptuar për të pandehurin, gjykata vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të pandehurin do ta parandalojë që në të ardhmen të mos kryejë vepra tjera penale dhe do të ndikojë edhe tek qytetarët tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale të kësaj natyre.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 paragrafi 1, e në lidhje me nenin 450 paragrafi 1 nën paragrafi 2.6 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 275 paragrafi 3 të KPRK-së, të pandehurit Përparim Qerimoviq, i konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuanë në peshë prej 0,6 gr. e sekuestruar nga ana e policisë më dat. 23.08.2016.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.1104/2016, më 19.07.2017**

Procesmbajtësi
Ali Kryeziu

Gjyqtari
Islam Thaçi, d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.

